

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Auditim
Zgjidhjet

P6

Data 22/06/2019

Detyra 1

(a) Jeni duke audituar KLC Shpk për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018. Kompania ju ka paraqitur regjistrin e pasurive joqarkulluese më poshtë:

| | Prona Shënimi (i) | Pajisje printimi Shënimi (ii) | Pajisje zyre Shënimi (iii) | Mobilje zyre Shënimi (iv) | Total |
|---------------------------------|----------------------|-------------------------------------|-------------------------------|------------------------------|-----------|
| Gjendja fillestare 1 janar 2018 | 0 | 110,219 | 98,725 | 81,234 | 290,178 |
| Shtesat | 725,000 | 89,621 | 17,978 | 5,350 | 837,949 |
| Shitjet/heqjet nga përdorimi | 0 | (79,540) | (11,621) | (831) | (91,992) |
| Gjendja me 31 dhjetor 2018 | 725,000 | 120,300 | 105,082 | 85,753 | 1,036,135 |

Shënime:

- Shtesat lidhur me pronat përbëhen nga zyrat e reja qendrore dhe parkingu. Në të kaluarën kompania kishte zyrat me qira.
- Shtesat dhe heqjet lidhur me pajisjet e printimit kanë të bëjnë me 2 printer 3D dhe katër makina të fotokopjes.
- Kompania kishte blerë një server (kompjuter) dhe kishte hequr nga përdorimi/shitur një server tjetër.
- Shtesat dhe heqjet nga përdorimi të mobiljet përbëhen nga bleraj dhe shitja e artikujve të ndryshëm.

Kërkohet:

Përgatitni një listë prej 10 procedurave të pavarura të auditimit për seksionin e pronës dhe pajisjeve të pasqyrës së pozicionit financiar të cilat mund të zbatohen në testimin e pohimeve në vijim:

- Ekzistenca dhe ndodhja
- Plotësia
- Saktësia dhe klasifikimi
- Vlerësimi dhe shpërndarja
- Të drejtat dhe obligimet
- Paraqitjen dhe shpalosjen

Nuk kërkohet të konsideroni punën e auditimit lidhur me fushat e pasqyrës së të ardhurave. Për secilën procedurë të auditimit duhet të tregoni cilin pohim të pasqyrave financiare e adresojnë. (15 pikë)

(b) Lidhur me SNK 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet (PIP):

- (i) Cilat janë elementet e kostos që mund të përfshihen në regjistrimin e një PIP në pasqyrat financiare? (5 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

| Procedurat e auditimit/ testet | Pohimet |
|---|---|
| Sigurohu që saldot e bartura në PIP në librin kryesor përputhen me pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor | Plotësia, Paraqitja |
| Rishiko harmonizimin e regjistrit të PIP me librin kryesor nëse përputhen | Plotësia, Saktësia, |
| Rishiko rezultatet e verifikimit të pasurive në PIP që janë kryer nga kompania për të përcaktuar punën shtesë të auditimit. | Plotësia, Ekzistenca |
| Përzgjedh një mostër të pajisjeve të printimit, pajisjeve të zyrës dhe mobiljeve dhe ekzamino fizikisht ato. | Ekzistenca |
| Selektoni fizikisht disa nga artikujt e PIP dhe ndjekni deri në regjistrin e PIP | Plotësia, Ekzistenca |
| Për artikujt e ekzaminuar fizikisht më sipër, kontrollo gjendjen e tyre nëse ende janë duke u përdorur nga kompania. Konsidero implikimet në vlerën e tyre. | Vlerësimi dhe shpërndarja, të drejtat dhe obligimet |
| Ekzamino dokumentet e pronësisë dhe kontratat | Të drejtat |
| Merr detajet e buxhetit të kompanisë lidhur me PIP dhe rishiko variancat. | Plotësia |
| Rishiko procesverbalet e takimit të drejtorëve për detajet e ndonjë shtese kapitale dhe krahaso me shpenzimet aktuale. Heto çfardo variance materiale. | Plotësia |
| Rishiko kostot e riparimeve dhe mirëmbajtjes nëse ka raste kur janë trajtuar gabimisht në vend se të kaitalizohen. | Plotësia , vlerësimi, paraqitja, të drejtat |
| Për pronat e blera rishiko vendimet e drejtorëve, faturat/kontratrat, fletëposedimet e kadastrës, nëse janë përfshirë në listën e aseteve dhe në librin kryesor. | Vlerësimi, paraqitja, të drejtat, saktësia |
| Për shtesat në të gjitha kategoritë e PIP rishiko nëse ka autorizim të duhur dhe ndjekni artikujt deri te faturat, kontratat, fletëpranimet dhe nëse janë regjistruar në regjistrin e pasurive dhe në librin kryesor. | Vlerësimi, paraqitja, të drejtat |

Elementet e kostos

Kostot e artikujve të pronë, impianteve dhe pajisjeve përbëhen nga:

- Çmimi i blerjes, përfshirë doganën dhe taksat e parmbursueshme, pas zbritjes së rabateve.
- Çfardo kosto që është direkt e atribuueshme për ta sjellur pasurinë në lokacionin dhe kushtet e domosdoshme për operim
- Vlerësimet fillestare të kostos së çmontimit dhe kostos së restaurimit të lokacionit në të cilin ndodhet pasuria

Detyra 2

(a) AutoFiu ShA është kompani që shet autopjesë me shumicë dhe pakicë. Stoqet e kompanisë blihen nga një numër i madh furnitorësh. Ju keni filluar punët e auditimit dhe jeni duke testuar sistemet e blerjes dhe do të merrni pjesë në numërimin e stoqeve. Në ditën e numërimit të stoqeve, ju keni vizituar depon kryesore të kompanisë dhe keni vëzhguar aktivitetet në vijim:

- Personeli i numërimit ka fletët e paranumëruar të stoqeve në të cilat janë përfshirë sasitë e stoqeve dhe emërtimi i tyre.
- I gjithë personeli i përfshirë në numërim janë punonjës të depos dhe janë ndarë në ekipe nga dy anëtarë.
- Tri ekipe të numërimit janë alokuar për secilën zonë të depos, edhe pse ekipeve ju lejohet të vendosin se cilën zonë të numërojnë. Personelit u është thënë se duhet të mbajnë në mend cilin stok e kanë përfunduar numërimin.
- Informatat regjistrohen në fletë-numërime me laps të thjeshtë grafik, për arsye se ndryshimet në sasi mund të bëhen më lehtë, nëse është e nevojshme.
- Stoqet që nuk janë të përfshira në fletë-numërime, regjistrohen në fletë të veçanta. Këto fletë të veçanta nuk janë të paranumëruara por personeli i numërimit vet ia cakton nga një numër.
- Në fund të numërimit, të gjitha fletë-numërimet mblidhen dhe kontrollohen numrat serik të njëpasnjëshëm; fletët nuk nënshkruhen.

Kërkohet:

- (i) Përshkruani KATËR procedura që auditori i kryen para se të merr pjesë në numërimin e stoqeve. (4 pikë)
- (ii) Analizoni mangësitë dhe ndikimin e tyre në sistemin e numërimit të stoqeve të kompanisë. Rekomandoni se si duhet të përmirësohet secila mangësi e identifikuar. (12 pikë)
- (iii) Diskutoni rrezikun në kontekstin e auditimit. Përgjigja juaj duhet të përshkruaj përbërësit e rrezikut. (9 pikë)

[Total: 25 Pikë]

Zgjidhja

(a) (i)

Procedurat

- Rishikimi i letrave të punës së vitit të kaluar për të identifikuar çfardo çështje me të cilat është ballafaquar auditori.
- Përfitimi i udhëzimeve për numërim të stoqeve nga klienti për të siguruar se ka kontrolle dhe procedura të përshtatshme gjatë numërimit.
- Pyetja e manxhmentit nëse ka stoqe që mbahen nga palët e treta dhe vlerësimi nëse duhet të marrim pjesë në numërim të stoqeve në ato lokacione.
- Caktimi i stafit të auditimit për të marrë pjesë në numërim të stoqeve duke u siguruar se stafi ka përvojën e mjaftueshme. Gjithashtu përcaktimi i numrit të stafit për të mbuluar mjaftueshëm stoqet e klientit.

(ii)

| Mangësia | Arsyeja e mangësisë | Rekomandimi për përmirësim |
|--|---|---|
| Fletët e numërimit përmbajnë sasinë e artikujve që pritet të gjenden në depo/shitore | Ekipet e numërimit ka gjasë të bëjnë nënvlerësim të stoqeve, pasi që mund të ndalin numërimin pasi të gjejnë numrin e 'saktë' të stoqeve | Fletët e numërimit nuk duhet të përmbajnë sasinë e stoqeve për të mos paragjykuar numërimin e stoqeve në depo |
| Anëtarët e ekipit të numërimit janë nga shitoret | Anëtarët e numërimit janë përgjegjës për stoqet. Mund të ekzistoj motivi për të fshehur gabimet ose stoqet që mungojnë dhe të cilat janë larguar me qëllim nga kompania | Ekipet e numërimit duhet të përfshijnë personel që nuk është përgjegjës për stoqet për të siguruar pavarësi në procesin e numërimit |
| Ekipet e numërimit kanë vendosur vet cilat zona të stoqeve të numërojnë | Ekziston rreziku që ekipet të anashkalojnë ndonjë zonë ose të numërojnë dy herë ndonjë zonë, në mungesë të udhëzimeve të qarta | Secilit ekip duhet ti caktohet zonë e saktë për tu numëruar |
| Fletët e numërimit nuk janë nënshkruar nga personeli i numërimit | Mungesa e nënshkrimit e bën të vështirë ngritjen e çështjeve lidhur me artikujt e numëruar pasi që nuk dihet kush i ka numëruar | Të gjitha fletët e numërimit duhet të nënshkruhen për të konfirmuar se kush e ka kryer numërimin |
| Stoqet nuk janë shenjzuar për të treguar se janë numëruar | Si më sipër, ka rrezik se stoqet mund të anashkaloohen ose numërohen dy herë | Stoqet duhet të shenjzohen si të numëruara |
| Shënimi i stoqeve në fletët e numërimit bëhet me laps | Nëse shënohen me laps ekziston rreziku se shënimet mund të ndryshohen | Fletët e numërimit duhet të plotësohen me ngjyrë |

(iii) Rreziku i auditimit

Rreziku i auditimit është rreziku që auditori të jep opinion të papërshtatshëm mbi pasqyrat financiare; psh të dështoj të rezevoj opinionin kur pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale. Rreziku i auditimit përbëhet nga tre përbërës:

Rreziku i auditimit = Rreziku i vetvetishëm x Rreziku i kontrollit x Rreziku i moszbulimit

Rreziku i vetvetishëm

Është ndjeshmëria e një pohimi ndaj anomalisë që mund të jetë materiale individualisht ose e agreguar, duke supozuar se nuk ka pasur kontrolle përkatëse,

Rreziku i kontrollit

Rreziku që sistemi i kontrollit të brendshëm do të dështoj të parandaloj ose zbuloj anomalinë materiale.

Vlerësimi paraprak nga auditori i kontrolleve i ndihmon atij të përcatoj rrezikun e kontrollit.

Rreziku i moszbulimit

Ky është rreziku që auditori do të dështoj të zbuloj anomalinë materiale në ndonjë pohim.

Detyra 3

Ju jeni seniori i auditimit dhe keni filluar auditimin e kompanisë NECO Shpk. NECO është kompania e shpërndarjes së djathit për rajonin e Ballkanit dhe rrjeti i shpërndarjes mbulon katër shtete: Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Për të siguruar vijimësinë e furnizimit, kompania ka nga një depo për secilin shtet. Zyrat kryesore të kompanisë janë në Prishtinë në të cilat është e vendosur administrata, funksioni i blerjes dhe kontabilitetit për të katër shtetet. Për shkak të shtrirjes gjeografike të tregjeve të kompanisë, është e rëndësishme që kompania të ketë kontrolle të mira të brendshme. Gjatë punës tuaj të auditimit, ju do të kryeni ekzaminim të detajuar të mjedisit të kompanisë NECO përfshirë kontrollet e brendshme.

Kërkohet:

- (a) Shpjegoni çka do të thotë 'mjedisi i kontrollit të brendshëm' dhe vlerësoni TRE faktorë kryesor që do të reflektohen në mjedisin e kontrollit të kompanisë siç është NECO. (7 pikë)
- (b) Diskutoni pse është e rëndësishme që auditori të përftojë njohuri për kompaninë dhe mjedisin e saj, përfshirë kontrollet e brendshme. (5 pikë)
- (c) Shpjegoni çka janë testet e kontrollit dhe listoni disa nga testet e kontrollit. (3 pikë)

[Total: 15 Pikë]

Zgjidhja

(a) Mjedisi i kontrollit të një kompanie i referohet mjedisit të krijuar nga drejtorët dhe ekzekutivët e kompanisë përmes sjelljes së tyre vetëdijes dhe veprimeve lidhure kontrollet e brendshme dhe rëndësisë së tyre për kompaninë.

Faktorët kryesorë që reflektohen në mjedisin e kontrollit të NECO janë:

- Mënyra se si komunikohen parimet e integritetit, vlerave dhe etikës në kompani
- Konsiderimi i nivelit të kompetencave që kërkohen për punët e caktuara
- Sjellja e drejtorëve të bordit – në veçanti pavarësia nga drejtorët ekzekutiv, përvoja e tyre, shkalla më të cilën ata e ndjekin ndonjë çështje dhe bashkëveprimi i tyre me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm
- Filozofia dhe stili operativ i drejtorëve ekzekutiv, qasja e tyre në menaxhimin e rreziqeve biznesore, sjellja e tyre ndaj funksionit të kontabilitetit dhe raportimit financiar
- Struktura organizative brenda kompanisë përmes së cilës kompania planifikon, përpiqet të përmbushë dhe kontrollojë dhe rishikoj objektivat e saj
- Si caktohen përgjegjësitë dhe autoriteti për aktivitetet operative
- Politikat e burimeve njerëzore, siç janë punësimi, orientimi, trajnimi, vlerësimi, promovimi, kompenzimi

(b) Përfitimi i njohurisë për entitetin dhe mjedisin e tij përfshirë kontrollet e brendshme është process dinamik i grumbullimit, azhurnimit dhe analizimit të informatave përgjatë auditimit.

- Vlerësimi i rrezikut të anomalive materiale në pasqyrat financiare
- Përcaktimi i materialitetit
- Konsiderimi i përshtatshmërisë së përzgjedhjes dhe zbatimit të politikave të kontabilitetit dhe mjaftueshmëria e shpalosjeve të pasqyrave financiare
- Identifikimi i fushave në të cilat ka nevojë për konsiderata të veçanta të auditimit, psh transaksionet me palët e lidhura, përshtatshmëria e përdorimit të hipotezës së vijimësisë
- Zhvillimi i pritjeve për përdorim në procedurat analitike
- Përgjigja ndaj rrezikut të vlerësuar të anomalive materiale, përfshirë dizanimin e procedurave të mëtutjeshme të auditimit

(c) Testet e kontrollit dhe procedurat thelbësore

Testet e kontrollit vlerësojnë efektivitetin e kontrolleve të brendshme në parandalimin, zbulimin dhe korigjimin e anomalive material në nivel të pohimit.

Shembuj të testeve të kontrollit në sistemin e pagave:

- Inspektimi i sekuencës numerike të listave të ardhje/shkuarjeve të punonjësve; nëse ka ndonjë sekuencë të ndërprerë, pyetni menaxhmentin lidhur me dokumentin që mungon.
- Rishikimi i kartelave të ardhje/shkuarjeve për të dokumentuar autorizimin e punës jashtë orarit nga personi përgjegës.
- Vëzhgimi nëse ka ndarje të duhur të detyrave në mes të burimeve njerëzore dhe departamentit të pagave.

Detyra 4

Jashari Shpk prodhon makina për kositje dhe përbërës të tyre, viti fiskal përfundon me 31 dhjetor 2018. Ju jeni senior i auditimit të firmës ADF Audit dhe jeni duke filluar auditimin përfundimtar të Jashari. Pasuritë totale të kompanisë janë €43.2 milion dhe fitimi para tatimit është €7.2 milion. Në vijim janë paraqitur çështjet për tu konsideruar nga ju:

Llogaritë e arkëtueshme

Libri i llogarive të arkëtueshme përbëhet nga një numër i madh i konsumatorëve. Në vitin e kaluar, ekipi i auditimit kishte dërguar konfirmime pozitive të llogarive të arkëtueshme për të konfirmuar saldot përfundimtare të tyre. Mirëpo, përgjigjet nga konsumatorët ishin shumë të pakta prandaj auditorët kishin përdorur procedura alternative të auditimit. Këtë vit ishte marr vendim nga auditorët që të mos kryhej konfirmimi i llogarive të arkëtueshme.

Saldo përfundimtare e llogarive të arkëtueshme është €3.9 milion (2017: €2.8 milion) dhe lejimet për llogaritë e arkëtueshme janë €410,000 (2017: €300,000).

Paraja

Zëri i bankës dhe parasë në pasqyrat financiare të Jashari përbëhej nga një numër i llogarive bankare: një overdraft prej €5.1 milion që është llogaria kryesore operative e kompanisë dhe disa llogari të kursimeve në vlerë totale prej €0.2 milion. Drejtori financiar informoi menaxherin e auditimit se të gjitha llogaritë bankare janë harmonizuar në fund të vitit. Overdrafti prej €5.1 milion është rritur në mënyrë domethënëse nga viti i kaluar (2017: €1.2 milion). Drejtorët ju kanë informuar se overdrafti i cili përdoret për aktivitetet operative duhet të rinovohet në shkurt të vitit 2019 dhe se janë të sigurt se do të rinovohet.

Kërkohet:

- (a) Përshkruani procedurat e pavarura që auditori duhet të kryej për të përfutur evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me llogaritë e arkëtueshme të Jashari. (5 pikë)
- (b) Përshkruani procedurat që duhet të kryej auditori për të përfutur evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për gjendjet e banksë së kompanisë Jashari. (5 pikë)
- (c) Përshkruani procedurat e auditimit që duhet të kryhen nga auditori për të përcaktuar nëse Jashari është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë. (5 pikë)

Gjatë auditimit përfundimtar, drejtori financiar ju ka informuar se banka nuk do të merr vendim për rinovimin e overdraftit para se të nënshkruhet raporti i auditorit. Partneri i auditimit është i kënaqur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare sipas hipotezës së vijimësisë. Drejtorët janë pajtuar të përfshijnë një shënim të shkurtër në pasqyrat financiare për të shpalosur çështjet me hipotezën e vijimësisë dhe ekipi i auditimit ende duhet të vlerësojë nëse ato shpalosje janë të mjaftueshme.

Kërkohet:

- (d) Diskutoni çështjen dhe përshkruani ndikimin në raportin e auditorit të Jashari nëse shpalosjet për hipotezën e vijimësisë në rast se janë të mjaftueshme ose të pamjaftueshme. (5 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a) Procedurat e pavarura për llogaritë e arkëtueshme (LLA)

- Merr listën e moshimit të LLA dhe përputh me saldot në librin e shitjeve dhe në bilancin vërtetues
- Rishiko librin e LLA dhe analizon llogaritë që nuk paguhen për një periudhë të gjatë, diskuti me menaxhmentin nëse konsumatorët kanë gjasa të paguajnë
- Përzgjedh një mostër të LLA dhe ndjek pagesat pas datës së raportimit
- Rishikon korrespondencat me konsumatorët nëse ka mosmarrëveshje për pagesë
- Llogarit mesataren e ditëve të LLA dhe krahas me vitin e kaluar
- Inspekto kthimet e shitjeve pas fundit të vitit dhe vlerëso nëse duhet të llogaritet ndonjë lejim për LLA
- Merr tabelën e lejimeve të LLA dhe rillogarit gjendjet duke konsideruar nëse duhet të ndryshohet saldoja e lejimeve
- Merr një mostër të fletëdërgesave të mallit para dhe pas fundit të vitit dhe ndjekni deri te libri i shitjes për të konfirmuar se janë regjistruar në periudhën e duhur
- Përzgjedh një mostër të saldove të LLA dhe përputh me dokumentacionin mbështetës

(b) Procedurat e pavarura për gjendjet e bankës

- Merr konfirmimet nga banka për të gjitha llogaritë bankare
- Përputh të gjitha llogaritë bankare nga letra e konfirmimit bankar me saldot në bilancin vërtetues për të siguruar plotësinë
- Merr një harmonizim bankar dhe krahaso saldot me gjendjen në bankë dhe librin kryesor
- Rishiko librin e arkës dhe raportet nga banka për ndonjë transfer të pazakonshëm afër fundit të vitit
- Ekzamino konfirmimin nga banka për evidenca të overdraftit
- Për llogaritë e kursimeve, rishiko artikujt që duhet të harmonizohen dhe përputh me librin kryesor
- Rishiko pasqyrat financiare për tu siguruar se gjendje e bankës janë shpalosur mjaftueshëm

(c) Procedurat për hipotezën e vijimësisë

- Përfito parashikimin e rrjedhës së parasë nga kompania dhe rishiko hyrjet dhe daljet e parasë. Vlerëso supozimet nëse janë të arsyeshme dhe diskuto gjetjet me menaxhmentin për të kuptuar nëse kompania ka para të mjaftueshme
- Kryej analizën sensitive në rrjedhën e parasë për të kuptuar marxhinën e sigurisë (mbulesën e daljeve me hyrje të parasë)
- Vlerëso planet e menaxhmentit për veprimet në të ardhmen përfshirë planet eventuale për të gjeneruar të hyra dhe fizibilitetin e atyre planeve
- Rishiko shitjet pas fundit të vitit për të vlerësuar nëse ka gjasa të rriten nivelet e shitjes dhe nëse shifrat e të hyrave në parashikim janë të arsyeshme
- Rishiko nëse ka marrëveshje me banka për të përcaktuar a ka pasur shkelje të kushteve të kontratave sidomos për overdraftin
- Rishiko korrespondencat me furnitorët pas fundit të vitit nëse ka raste të hedhjes në gjyq për ndonjë rast mospagese
- Me miratim të klientit komunikoni me avokatët e kompanisë për ndonjë rast të hapur gjyqësor
- Kryeni testet për ngjarjet pas datës së raportimit për të identifikuar faktorët që rrisin rrezikun e hipotezës së vijimësisë

(d) Raporti i auditorit

Ndikimi mbi raportin e auditorit varet nëse pasiguria materiale është shpalosur mjaftueshëm në pasqyrat financiare.
Shpalosje e mjaftueshme

Raporti i auditorit duhet të përfshijë seksionin e hipotezës së vijimësisë lidhur me pasigurinë materiale. Seksioni do të theksojë se opinioni nuk është modifikuar, të tregojë se ekziston një pasiguri materiale dhe do të referohet shënimit në pasqyrat financiare të bërë nga menaxhmenti. Ky seksion do të përfshihet pas opinionit dhe bazës për opinion.

Shpalosje e pamjaftueshme

Opinion i auditorit duhet të modifikohet pasi që ka anomali materiale për shkak të shpalosjes së pamjaftueshme. Dështimi për të shpalosur mjaftueshëm ka gjasë të jetë materiale por jo përhapëse për shkak të natyrës së vazhdueshme të negociimit, prandaj një opinion me rezervë do të ishte i përshtatshëm. Raporti do të përmbajë paragrafin për bazën për opinion në të cilin shpjegohet ekzistenca e një pasigurie materiale për të cilën nuk ka shpalosje të mjaftueshme.

Detyra 5

(a) Përveç përparësive që i kanë të gjitha format e auditimit, një auditim jo - ligjor ka dhe përparësi të tjera.

Kërkohet:

Numëroni TRE përparësi të auditimit jo - ligjor të një partneriteti (6 pikë)

(b) SNA 610 Përdorimi i punës së auditorëve të brendshëm ofron udhëzime për auditorët e jashtëm mbi përdorimin e punës së auditimit të brendshëm.

Kërkohet:

Listoni dhe shpjegoni shkurt kriteret e ndryshme të cilat duhet të konsiderohen nga auditorët e jashtëm kur vlerësohet nëse mund të mbështeten në punën e kryer nga auditorët e brendshëm. (4 pikë)

(c) Listoni katër shembuj të dëshmive të auditimit të cilat mund të merren nga përdorimi i ekspertit të jashtëm. (4 pikë)

(d) ISA 620 Përdorimi i punës së ekspertit nga auditorët ofron udhëzime për auditorët të cilët mbështeten në punën e kryer nga një ekspert.

Kërkohet:

Listoni faktorët të cilët duhet të konsiderohen nga auditori kur vlerësohet puna e kryer nga një ekspert dhe shpjegoni cilat veprime duhet të ndërmerren nga auditori nëse vjen në përfundim se rezultatet e punës së ekspertit nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme ose nëse rezultatet nuk janë në pajtueshmëri me dëshmitë tjera të auditimit. (6 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Për shembull, auditimi i pasqyrave financiare të një **partneriteti** mund të shihet se ka përparësitë e mëposhtme.

- (i) Ofron një mënyrë të **stabilizimit të marrëdhënieve** midis partnerëve **në pasqyrat financiare**.
- (ii) Në rastet kur vihen në dispozicion pasqyrat financiare të audituara një gjë e tillë i bën **pasqyrat financiare më të pranueshme për autoritetet tatimore** sidomos për sa i takon fitimit të tatueshëm për një partner individual.
- (iii) **Shitja** e biznesit ose **negociatat për kredi** ose **për sigurimin e mbitërheqjeve (overdraft - it)** bëhen më të lehta në rastet kur firma është e aftë të paraqesë pasqyra të audituara financiare.
- (iv) Auditimi në emër të një '**partneri jo aktiv**' është shumë i dobishëm, meqenëse në përgjithësi një person i tillë nuk ka në dispozicion mënyra të tjera për të kontrolluar pasqyrat financiare të biznesit ose për të konfirmuar pjesën e fitimeve që i takojnë atij ose asaj.

(b) Kriteret të cilat duhet të konsiderohen kur vlerësohet mbështetja në punën e auditorit të brendshëm përfshinë:

Objektiviteti i funksionit

Auditori i jashtëm duhet të konsideroj se kujt i raporton auditori i brendshëm dhe nëse ai i nënshtrohet ndonjë përgjegjësie me konflikt, pengese ose ndalesë. Kjo do të ndikojë në aftësinë e auditorëve të brendshëm për të komunikuar çështjet domethënëse.

Fushëveprimi i funksionit

Auditorët e jashtëm duhet të konsiderojnë shtirjen dhe natyrën e angazhimeve të kryera nga auditorët e brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti si rezultat i raporteve të auditimit të brendshëm.

Kompetenca teknike

Auditorët e jashtëm duhet të konsiderojnë nëse auditorët e brendshëm kanë trajnimin dhe njohurinë e duhur teknike.

Kujdesi i duhur profesional

Auditorët e jashtëm duhet të konsiderojnë nëse puna e auditorëve të brendshëm është planifikuar, mbikqyrur, rishikuar dhe dokumentuar si duhet.

(c) Dëshmitë / evidencat e auditimit që mund të përftohen nga një ekspert:

- Vlerësimi i pasurive siç është toka dhe ndërtesat, pajisjet dhe makineritë, veprat e artit, gurët e çmuar.
- Përcaktimi i sasive dhe gjendjeve fizike të pasurive
- Përcaktimi i shumave duke përdorur teknika ose metoda të specializuara, siç janë vlerësimet aktuariale
- Matja e punës që do të përfundohet ose ka përfunduar lidhur me kontratat në proces
- Mendimet ligjore sa i përket interpretimeve të marrëveshjeve, statuteve dhe rregulloreve

(d) Faktorët që duhet të konsiderohen kur vlerësohet puna e kryer nga një ekspert në auditim:

- Relevanca dhe arsyeshmëria e punë dhe konsistenca me dëshmit tjera të auditimit
- Relevanca dhe arsyeshmëria e çfardo supozimeve dhe metodave të përdorura
- Relevanca, plotësia dhe saktësia e çfardo të burimi të të dhënave të përdorura

Nëse rezultatet e punë së ekspertit nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të të përshtatshme ose nuk në konsistencë me dëshmitë e auditimit, auditori duhet të zgjedhë çështjen. Kjo mund të bëhet përmes diskutimeve me entitetin dhe ekspertin, duke zbatuar procedura shtesë të auditimit, përfshirjen e ndonjë eksperti tjetër, ose duke e modifikuar raportin e auditimit (kjo është zgjidhja e fundit vetëm nëse çështjet mbeten të pazgjidhura).